

Në bazë të nenit 16 paragrafi 1 alineja 6 të Ligjit për menaxhimin me pronën e konfiskuar, dobinë pasurore dhe sendet e marra në procedurë penale dhe kundërvajtëse (*) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 64/24, nr. 37/25, 86/25, 101/25, 135/25 dhe 132/26) dhe në përputhje me nenin 15 paragrafi 1 alineja 6 të Statutit të Agjencisë së menaxhimit me pronën e konfiskuar nr. 02-4368/2 të datës 02.12.2024, Bordi Drejtues i Agjencisë së menaxhimit me pronën e konfiskuar në mbledhjen e vet të 10-të me radhë për vitin 2026, të mbajtur më datë 16.07.2026, miratoi këtë

R R E G U L L O R E PËR VEPRIMIN ME PRONËN E KONFISKUAR

1.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohet mënyra e veprimit me pronën e marrë përkohësisht, pronën e konfiskuar, dobinë pasurore dhe sendet e marra në procedurë penale dhe kundërvajtëse, evidentimi, vendosja, ruajtja dhe dorëzimi i saj, si dhe mënyra e shitjes së sendeve të marra, procedura e shitjes me shitje publike elektronike, depozitimi dhe pagesa e çmimit në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe marrja e sendeve nga ana e blerësit.

Punonjësit e Agjencisë së menaxhimit me pronën e konfiskuar (në tekstin e mëposhtëm: Agjencia) me pronën e marrë përkohësisht ose sendet e marra përkohësisht, pronën e konfiskuar, dobinë pasurore dhe sendet e marra sillen si amvisë të mirë dhe afaristë të ndërgjegjshëm.

Neni 2

Terma të caktuar në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

"Pronë e konfiskuar (e marrë)" është prona e marrë përkohësisht dhe sendet e marra përkohësisht si dhe prona e konfiskuar dhe dobia pasurore si rendiment nga vepra penale dhe sendet e marra me vendim të plotfuqishëm në procedurë penale dhe kundërvajtëse, si dhe sendet e marra përgjithmonë në procedurë administrative.

"Pronë e marrë përkohësisht dhe sende të marra përkohësisht" janë sendet që sipas Kodit Penal duhet të merren ose që mund të shërbejnë si provë në procedurën penale, për konfiskimin përfundimtar respektivisht marrjen e të cilave nuk është sjellë vendim i plotfuqishëm.

"Pronë e konfiskuar dhe dobi pasurore si rendiment nga vepra penale dhe sende të marra" nënkuptojnë pronën e theksuar dhe dobinë pasurore si rendiment nga vepra penale dhe sendet e konfiskuara ose të marra me vendim të plotfuqishëm.

"Përmbauesit publikë të Agjencisë" janë persona të punësuar në Agjenci të cilët e marrin pronën e konfiskuar në procedurë penale dhe kundërvajtëse dhe më tej e vendosin dhe e ruajnë në ndonjë nga magazinat e Agjencisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë vendit.

"Dorëzuesi i sendeve" është personi i autorizuar nga institucioni kompetent që ka marrë sendet, pronën dhe dobinë pasurore.

2. NJOFTIMI DHE DORËZIMI I SENDEVE TË MARRA NË AGJENCINË E MENAXHIMIT ME PRONËN E KONFISKUAR

Neni 3

Gjykata ose organi tjetër shtetëror që ka sjellë vendim të plotfuqishëm ose vendim për marrjen e përkohshme të pronës, dobisë pasurore ose sendeve, në afat prej 3 ditësh nga pranimi i vendimit e njofton Agjencinë dhe i dorëzon sendet e marra, pronën e konfiskuar dhe dobinë pasurore.

Gjatë dorëzimit të pronës së marrë përkohësisht dhe sendeve të marra përkohësisht, si dhe pronës së konfiskuar dhe sendeve të marra në Agjenci, gjykata dhe organet e tjera

shtetërore janë të detyruara të dorëzojnë vlerësimin e vlerës së pronës së marrë përkohësisht dhe sendeve të marra përkohësisht, si dhe të pronës së konfiskuar dhe sendeve të marra, përveç për sendet për të cilat sipas Ligjit për menaxhimin me pronën e konfiskuar, dobinë pasurore dhe sendet e marra në procedurë penale dhe kundërvajtëse (*) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 64/24, 37/25, 86/25, 101/25, 135/25 dhe 132/26) është paraparë asgjësimi.

Neni 4

Dorëzimi i pronës së paluajtshme ose dobisë pasurore që përbëhet nga prona e paluajtshme dhe sendet e paluajtshme të marra, i dorëzohen përmbauesit kompetent të Agjencisë në vendin ku ndodhet paluajtshmëria, nëse paraprakisht janë siguruar çelësat nga ana e gjykatës, respektivisht organit që ka marrë pronën, me ç'rast përpilohet procesverbal për pranim-dorëzim, në 4 ekzemplarë, me të cilin konfirmohet pranimi i pronës së konfiskuar dhe i tërë dokumentacionit, menjëherë, e më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e marrjes.

Dorëzimi i dobisë pasurore dhe sendeve të marra, kur nuk bëhet fjalë për paluajtshmëri, bëhet në magazinat e Agjencisë, me ç'rast përpilohet procesverbal për pranim-dorëzim në 4 ekzemplarë, me të cilin konfirmohet pranimi i sendeve të marra dhe i tërë dokumentacionit, menjëherë, e më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e marrjes.

Sendet e marra përkohësisht gjatë marrjes fotografohen nga ana e përmbauesve dhe fotografitë e tyre bashkëngjiten në dosjen për sendet e marra.

Procesverbalet për pranim-dorëzim të sendeve të marra, mallit të marrë dhe pronës së konfiskuar janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 5

Për sendet e marra dhe pronën e konfiskuar mbahet evidencë. Mënyra e mbajtjes së evidencës është e rregulluar me Rregullore të veçantë për mënyrën e mbajtjes së evidencës së të dhënave për pronën e konfiskuar.

Neni 6

Përmbauesit dhe/ose personat e autorizuar të Agjencisë pas pranimi të pronës së konfiskuar janë të detyruar të sillen me të njëjtën si amvisë të mirë dhe afaristë të mirë. Udhëheqësi i Sektorit për punë operative i Agjencisë kryen kontrollin e mënyrës së ruajtjes dhe veprimit me pronën dhe sendet e marra, dhe në rast se vërtetohet parregullsi në veprim, menjëherë të ndërmerren masa për sjelljen e pronës në gjendje të rregullt, ndërsa nëse parregullsia e vërtetuar është bërë me qëllim ose me pakujdesi të madhe, udhëheqësi është i detyruar të ngrejë edhe procedurë përkatëse kundër personave përgjegjës.

Neni 7

Nëse për shkaqe të arsyeshme dorëzimi i sendeve të marra përfundimisht të përmbauesi i Agjencisë nuk mund të bëhet menjëherë ose në afat prej 3 ditësh nga dita e sjelljes së vendimit, i njëjti është i detyruar që përmes telefonit ose përmes e-mailit ta njoftojë institucionin që ka marrë sendin se nuk është në gjendje t'i marrë menjëherë sendet dhe t'i urdhërojë personit përgjegjës që përkohësisht ta ruajë pronën në magazinat e tyre.

Neni 8

Gjatë pranim-dorëzimit të sendeve të marra të cilat tashmë ndodhen për ruajtje në ndonjë prej magazinave të institucioneve që i kanë marrë në procedurë penale dhe kundërvajtëse para se të fillojnë me punë përmbauesit e Agjencisë, përpilohet procesverbal i ri për marrjen e sendeve, pronës dhe dobisë pasurore nga ana e përmbauesve të Agjencisë, dhe verifikohet nëse të njëjtat sende, pronë dhe dobi pasurore u përgjigjen të dhënave nga

procesverbal i kur për herë të parë është bërë pranim-dorëzimi i sendeve në magazinat e institucioneve kompetente prej nga merren.

Neni 9

Nëse përmbaruesit vërtetojnë se të dhënat gjatë marrjes së sendeve të marra nga magazinat, si dhe gjendja faktike e sendeve, pronës dhe dobisë pasurore që merren, nuk u përgjigjen të dhënave nga procesverbal i fillestar nga neni 8 me të cilin për herë të parë është bërë pranim-dorëzimi, janë të detyruar ta njoftojnë Drejtorin e Agjencisë me qëllim që ai ta njoftojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. VEPRIMI ME PRONËN E KONFISKUAR

Neni 10

Agjencia është e detyruar të sigurojë vlerësimin e vlerës së pronës së marrë përkohësisht dhe sendeve të marra përkohësisht, si dhe të pronës së konfiskuar dhe sendeve të marra vetëm në rast të tjetërsimit të tyre, (në përputhje me atë që është paraparë në nenin 35 bashkë me nenin 40 paragrafi 3 të Ligjit për menaxhimin me pronën e konfiskuar, dobinë pasurore dhe sendet e marra në procedurë penale dhe kundërvajtëse (*) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 64/24, 37/25, 86/25, 101/25, 135/25 dhe 132/26)), shitjes ose dhënies me qira, të përgatitur nga Byroja e Vlerësimit, vlerësues të autorizuar ose vlerësues të punësuar në Agjenci. Vlerësimin mund ta kryejnë edhe vlerësues të autorizuar nga organet e tjera shtetërore, pa kompensim.

Neni 11

Nëse përkohësisht janë marrë sende me vlerë të veçantë historike, shkencore ose artistike, Agjencia i dorëzon ato për ruajtje në institucionin përkatës kompetent për ruajtjen e këtij lloji të sendeve.

Pas plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin merren ose konfiskohen sendet nga paragrafi 1 i këtij neni, ato, pa kompensim, i tjetërsohen institucionit përkatës kompetent për ruajtjen e këtij lloji të sendeve, të përcaktuar me ligj.

Neni 12

Denarëve dhe devizave të marra përkohësisht u vërtetohen karakteristikat dhe cilësia nga Banka Popullore për çka përpilohet procesverbal.

Për denarët dhe devizat e marra, përveç të dhënave nga paragrafi 1, në procesverbalin për sendet e marra shënohen veç e veç prerjet (apoenet) dhe numrat serikë. Denarët dhe devizat e notuara kështu, më pas paguhën në llogari të veçantë të dedikuar të Agjencisë, me ç'rast si qëllim i dërgesës gjatë pagesës theksohet numri i procesverbalit dhe numri i vendimit për marrje nga organi kompetent.

Për gurët e çmuar dhe metalet fisnike (ar dhe argjend) të marra përkohësisht, personat e autorizuar të Agjencisë përgatisin kërkesë për deponimin e gurëve të çmuar dhe metaleve fisnike (ar dhe argjend) të marra përkohësisht dhe/ose përgjithmonë, dhe sipas terminimit të vërtetuar i dorëzojnë në Drejtorinë e Punëve të Thesarit të Bankës Popullore.

Pas verifikimit të kryer të gurëve të çmuar dhe metaleve fisnike (ar dhe argjend) të marra, sipas numrit, llojit dhe peshës vendosen në ambalazh përkatës dhe i dorëzohen për ruajtje Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut si depozitë e mbyllur – lënie për ruajtje, për çka personat e autorizuar nga Banka Popullore e RMV-së përpilojnë procesverbal/vërtetim që nënshkruhet nga të dyja palët, nga një ekzemplar për të dyja palët.

Veprimi me letrat me vlerë të marra

Neni 13

Shitja e aksioneve dhe pjesëve kapitale bëhet në bazë të vendimit për shitjen e aksioneve respektivisht pjesëve kapitale të sjellë nga Bordi Drejtues i AMPK-së, për të cilin vendim jep pëlqim Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 14

Aksionet shiten me anë të ankandit publik të bursës, në përputhje me Ligjin dhe rregullat e tregtimit të Bursës së Maqedonisë.

Neni 15

Agjencia e menaxhimit me pronën e konfiskuar në propozimin për shitjen e aksioneve në ankandin publik të bursës, mund të propozojë çmimin mesatar të arritur në dymbëdhjetë muajt e fundit në bursë për atë letër me vlerë, ndërsa procedura të zbatohet sipas Rregullave për organizimin e ankandit publik të bursës të aksioneve në pronësi të Shtetit të lëshuara nga Bursa e Maqedonisë.

Pas marrjes së pëlqimit nga paragrafi 1 i këtij neni, AMKP-ja e zbaton shitjen e aksioneve.

Neni 16

Shitja e aksioneve me anë të ankandit publik të bursës shpallet në afat prej 15 ditësh deri në 30 ditë para ditës së përcaktuar për ankandin publik të bursës, në të paktën dy gazeta ditore që dalin në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shpallja përmban:

- emrin dhe selinë e shoqërisë;
- kapitalin themeltar në shoqëri;
- vlerën e kapitalit që shitet;
- pjesëmarrjen në përqindje të aksioneve të AMKP-së në kapitalin e shoqërisë;
- çmimin fillestar të shitjes të një aksioni;
- modelin e shitjes;
- mënyrën e pagesës;
- datën e saktë të mbajtjes së ankandit publik të bursës.

Neni 17

Nëse në 12 muajt e fundit para ditës së shpalljes së shitjes së aksioneve ka pasur tregtim në bursë, çmimi fillestar i aksioneve në ankandin e parë publik të bursës vërtetohet në lartësinë e çmimit mesatar të arritur për atë aksion në 12 muajt e fundit sipas të dhënave nga Bursa e Maqedonisë, para ditës së sjelljes së vendimit nga neni 15 i kësaj Rregulloreje.

Nëse në 12 muajt e fundit para ditës së shpalljes së shitjes së aksioneve nuk ka pasur tregtim në bursë, çmimi fillestar vërtetohet në lartësinë e vlerës nominale të aksioneve që do të shiten në pesë ditë radhazi tregtare. Nëse pas pesë ditëve të para tregtare të ankandit të bursës aksionet mbeten të pashitura, AMPK-ja mundet që në pesë ditët e ardhshme radhazi tregtare ta zvogëlojë çmimin e aksioneve për 25% nga vlera nominale e aksionit, deri në shitjen e tyre përfundimtare.

Neni 18

Shitja e aksioneve bëhet sipas modelit „gjithçka ose asgjë“ me ç'rast aksionet shiten në paketë përmes një transaksioni ose sipas modelit „me copë“ përmes disa transaksioneve.

Neni 19

Shitja dhe pagesa e aksioneve bëhet në para të gatshme në denarë.

Neni 20

Agjencia e menaxhimit me pronën e konfiskuar pas pranimit të vendimit të plotfuqishëm për marrjen e pjesëve kapitale e regjistron atë në Librin e pjesëve kapitale dhe në Regjistrin Tregtar.

Pjesa kapitale e marrë vlerësohet nga vlerësuesi i autorizuar dhe shitet në shitje publike.

Procedura për shitjen e pjesëve kapitale do të zbatohet në përputhje me nenin 63 paragrafi 2 të Ligjit për menaxhimin me pronën e konfiskuar, dobinë pasurore dhe sendet e marra në procedurë penale dhe kundërvajtëse dhe në përputhje me nenet për shitjen e sendeve të marra me anë të shitjes publike të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 21

Menaxhimin me letrat me vlerë dhe pjesët kapitale në kuptim të nenit 7 të Ligjit për menaxhimin me pronën e konfiskuar, dobinë pasurore dhe sendet e marra në procedurë penale dhe kundërvajtëse, Agjencia e kryen në përputhje me dispozitat ligjore me të cilat rregullohet mënyra e menaxhimit me shoqëritë tregtare.

2) Veprimi me sendet e tjera të marra

Neni 22

Drogat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët e marrë i dorëzohen për ruajtje Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila i plotëson kushtet e parapara për ruajtje, për çka përpilohet procesverbal ku edhe bëhet ekspertiza e tyre.

Pas zbatimit të procedurave për sigurimin e mostrës për ekspertizë për drogat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët e marrë, në përputhje me dispozitat e LPP-së, me urdhër të organit kompetent të njëjtat asgjësohen.

Për nevojat e edukimit dhe aftësimit profesional, gjykata mund të sjellë vendim që një mostër nga drogat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët t'i tjetërsohen institucionit përkatës që kryen kërkime shkencore ose kryen veprimtari shkencore-edukative. Mostra merret nga ana e personave profesionistë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për çka përpilohet Procesverbal. Mostra tërhiqet nga ana e personave kompetentë nga institucionet të cilave u dorëzohet, ndërsa pranim-dorëzimi i mostrës bëhet përmes Komisionit për Asgjësim.

Neni 23

Në rastin kur organi kompetent do të sjellë vendim për asgjësim në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën Penale, drogat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët e marrë asgjësohen nga Komisioni për asgjësimin e drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve i formuar nga Bordi Drejtues.

Neni 24

Armët, pjesët dhe komponentët e armëve, municioni dhe materiali shpërthyes të marra në procedurë penale ose kundërvajtëse, si dhe armët e gjetura, pjesët dhe komponentët e armëve, municioni dhe materiali shpërthyes për të cilët nuk është zhvilluar procedurë penale dhe kundërvajtëse dhe as nuk dihet pronari i tyre, për shkak të mungesës së kushteve për ruajtje Agjencia i dorëzon për ruajtje në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

Armët, pjesët dhe komponentët e armëve, municioni dhe materiali shpërthyes i nënshtrohen ekspertizës në Ministrinë e Punëve të Brendshme lidhur me rregullsinë e tyre dhe për armët me defekt përpilohet procesverbal dhe inventar i armëve me defekt, pjesëve dhe komponentëve të armëve, municionit dhe materialit shpërthyes.

Armët me defekt, pjesët dhe komponentët e armëve, municioni dhe materiali shpërthyes nga paragrafi 2 i këtij neni asgjësohen pas marrjes së vendimit për asgjësim të sjellë nga organi kompetent ose gjykata në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën Penale, nga ana e komisionit për asgjësimin e armëve, municionit dhe materialit shpërthyes të marrë, i formuar nga Bordi Drejtues.

Armët e rregullta, pjesët dhe komponentët e armëve, municioni dhe materiali shpërthyes veçohen dhe mund të tjetërsohen me kërkesë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve, Policisë Financiare, policisë gjyqësore ose organit tjetër që ka të drejtë të përdorë armë, me pëlqim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Armët e rregullta, pjesët dhe komponentët e armëve, municioni dhe materiali shpërthyes që nuk do të tjetërsohen pa kompensim si në këtë nen të kësaj Rregulloreje jepen në shitje publike me rrugë elektronike, për shitje personave juridikë që merren me qarkullimin e armëve dhe municionit personave fizikë që kanë leje për furnizim me armë. Shitja bëhet në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje për shitjen e sendeve të marra.

Për nevojat e edukimit dhe aftësimit profesional, gjykata mund të sjellë vendim që një mostër nga armët e rregullta dhe të çaktivizuara, sipas ligjit, si dhe armët me defekt, si dhe pjesët dhe komponentët e armëve, t'i tjetërsohen institucionit përkatës që kryen kërkime shkencore ose kryen veprimtari shkencore-edukative. Mostra merret nga ana e personave profesionistë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për çka përpilohet Procesverbal. Mostra tërhiqet nga ana e personave kompetentë nga institucionet të cilave u dorëzohet, ndërsa pranim-dorëzimi i mostrës bëhet përmes Komisionit për Asgjësim.

Standardet për sigurinë dhe mënyra e ruajtjes dhe asgjësimit të armëve rregullohen me ligj të veçantë.

Bordi Drejtues me akt nënligjor e parasheh formularin e procesverbalit nga paragrafi 1 i këtij neni.

3) Veprimi me materialin e mbjelljes dhe farërave të marra përkohësisht dhe të konfiskuara, produktet bujqësore dhe të kopshtarisë së hershme, produktet për mbrojtjen e bimëve, ushqimin dhe pijet joalkoolike

Neni 25

Agjencia do të sjellë vendim që sendet e marra përkohësisht dhe të konfiskuara si materiali i mbjelljes dhe farërave, produktet bujqësore dhe të kopshtarisë së hershme, produktet për mbrojtjen e bimëve, ushqimi dhe pijet joalkoolike t'i tjetërsojë pa kompensim organeve shtetërore, institucioneve publike të themeluara nga shteti, shoqatave dhe fondacioneve, të regjistruara në përputhje me ligjin. Për këtë vendim Agjencia e njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Para tjetërimit të sendeve të marra përkohësisht dhe të konfiskuara nga paragrafi 1 i këtij neni, Agjencia siguron raport nga analizat për përcaktimin e makro dhe mikro elementeve dhe elementeve në gjurmë nga Laboratori Shtetëror Fitosemitar pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave ose nga institucionet e tjera relevante që kryejnë analizë dhe ekzaminim për përdorshmërinë e ushqimit. Pas marrjes së raportit, Agjencia i tjetërson sendet e marra përkohësisht nga paragrafi 1 i këtij neni.

Gjatë dorëzimit të mallit të marrë përkohësisht në Agjenci, institucioni që e ka marrë mallin e marrë përkohësisht dhe mallin e konfiskuar është i detyruar të dorëzojë dokument me të cilin do të konfirmohet rregullsia shëndetësore dhe higjienike e mallit të marrë përkohësisht (me prejardhje bimore ose shtazore), në të kundërt malli nuk do të pranohet nga ana e Agjencisë.

Bordi Drejtues me akt nënligjor e rregullon mënyrën e tjetërimit të sendeve të marra përkohësisht dhe sendeve të konfiskuara organeve shtetërore, institucioneve publike të themeluara nga shteti, shoqatave dhe fondacioneve.

Neni 26

Për veprimin me sendet e marra përkohësisht në procedurë penale, kundërvajtëse dhe administrative, siç janë materiali i mbjelljes dhe farërave i marrë përkohësisht, produktet bujqësore dhe të kopshtarisë së hershme, produktet për mbrojtjen e bimëve, ushqimi dhe pijet joalkoolike, Agjencia do të kërkojë mendim nga ana e raportit të analizave për përcaktimin e makro dhe mikro elementeve dhe elementeve në gjurmë nga Laboratori Shtetëror Fitosemitar pranë Ministrisë së Bujqësisë,

Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave ose nga institucionet e tjera relevante që kryejnë analizë dhe ekzaminim për përdorshmërinë e ushqimit. Në rast të mendimit negativ sendet asgjësohen në përputhje me nenin 71 të Ligjit për menaxhimin me pronën e konfiskuar, dobinë pasurore dhe sendet e marra në procedurë penale dhe kundërvajtëse (*).

Prona që përbëhet nga kafshë të gjalla u dorëzohet personave juridikë të veçantë, të cilët kanë regjistrim përkatës dhe licencë për veprim me kafshë të gjalla, me të cilët Agjencia ka lidhur marrëveshje kornizë përmes prokurimit publik i cili kryhet në nivel vjetor. Veprimi me kafshët të gjalla rregullohet me rregullore të veçantë.

Prona tjetër e konfiskuar e cila nuk mund të shitet, as të tjetërsohet pa kompensim për shkaqe shëndetësore, veterinare, sigurie, fitosanitare dhe shkaqe të tjera, si barna, falsifikate të duhanit, alkoolit dhe produkteve të tjera për të cilat nuk ekziston deklaratë, asgjësohen detyrimisht në deponi në përputhje me dispozitat ligjore pozitive.

4) Veprimi me sendet e marra përkohësisht si veshje dhe mbathje

Neni 27

Agjencia do të sjellë vendim që sendet e marra përkohësisht si veshje dhe mbathje t'i tjetërsojë pa kompensim organeve shtetërore, institucioneve publike të themeluara nga shteti, shoqatave dhe fondacioneve, të regjistruara në përputhje me ligjin. Për këtë vendim Agjencia e njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Bordi Drejtues me akt nënligjor e rregullon mënyrën e tjetërsimit të sendeve të marra përkohësisht organeve shtetërore, institucioneve publike dhe ndërmarrjeve, të themeluara nga shteti dhe komunat, shoqatave dhe fondacioneve.

5) Shitja ose tjetërsimi i pronës së marrë përkohësisht ose sendeve të marra përkohësisht – automjeteve motorike*

Neni 28

Prona e marrë përkohësisht ose sendet e marra përkohësisht nuk mund të jenë lëndë e shitjes ose tjetërsimit, përveç në rastet kur:

- menaxhimi me atë pronë ose sende lidhet me shpenzime më të mëdha ose shpenzimet për mirëmbajtje e tejkalojnë vlerën e pronës ose sendeve ose
- sendet e marra përkohësisht janë sende jashtë qarkullimit.

Në rastin nga paragrafi 1 alineja 1 e këtij neni, në afat prej 10 ditësh nga pranimi i njoftimit për pronën e marrë përkohësisht ose sendet e marra përkohësisht në procedurë penale veya kundërvajtëse, Agjencia i drejtohet pronarit të pronës, respektivisht të sendeve me qëllim të marrjes së pëlqimit për shitje ose tjetërsim. Nëse pronari nuk jep pëlqim ose nuk deklarohe në afatin nga paragrafi 4 i këtij neni, Agjencia në afat prej 10 ditësh i drejtohet për pëlqim organit që ka sjellë vendimin për marrjen e përkohshme në procedurë penale ose kundërvajtëse. Në rastin kur vendimin e ka sjellë gjykata, gjykata e jep pëlqimin në bazë të mendimit paraprak pozitiv nga prokurori publik kompetent. Pas marrjes së pëlqimit, Agjencia do të sjellë vendim për shitjen ose tjetërsimin e pronës së marrë përkohësisht ose sendeve të marra përkohësisht.

* Me automjete motorike nga ky nen i rregullores nënkuptohen „mjete me lëvizje motorike“, në përputhje me Ligjin për automjetet („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“) nr. 140/08, 53/11, 123/12, 153/12, 70/13, 164/13, 138/14, 154/15, 192/15, 39/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/19, 87/23, 148/25, 160/25, 258/25, 58/26 dhe 145/26)

Në rastin nga paragrafi 1 alineja 2 e këtij neni, në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit për sendet e marra përkohësisht, Agjencia i drejtohet për marrjen e pëlqimit për tjetërsim organit që ka sjellë vendimin për marrjen e përkohshme të sendeve në procedurë penale ose kundërvajtëse. Në rastin kur vendimin e ka sjellë gjykata, gjykata e jep pëlqimin në bazë të mendimit paraprak pozitiv të marrë nga prokurori publik kompetent.

Pëlqimin për shitje, respektivisht tjetërsim të pronës së marrë përkohësisht ose sendeve të marra përkohësisht në procedurë penale dhe kundërvajtëse, gjykata, organi, respektivisht pronari i pronës respektivisht sendeve, e jep në afat prej 15 ditësh nga pranimi i kërkesës nga Agjencia.

Agjencia në bazë të pëlqimit të marrë nga paragrafi 4 i këtij neni:

- do të sjellë vendim për shitjen e pronës së marrë përkohësisht, respektivisht sendeve të marra përkohësisht ose

- në përputhje me vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, sendet e marra përkohësisht do t'i tjetërsojë në organ shtetëror. Sendet e marra përkohësisht që janë jashtë qarkullimit mund t'u tjetërsohen vetëm organeve shtetërore nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes, organeve kompetente për ndjekje dhe policisë gjyqësore.

Vendimin për shitje, respektivisht vendimin për tjetërsim nga paragrafi 5 i këtij neni, Agjencia e sjell pas marrjes së pëlqimit dhe vlerësimit të siguruar të vlerës së pronës së marrë përkohësisht dhe sendeve të marra përkohësisht.

Agjencia siguron vlerësimin e vlerës së pronës së marrë përkohësisht dhe sendeve të marra përkohësisht të përgatitur nga Byroja e Vlerësimit, vlerësues të autorizuar, vlerësues të punësuar në Agjenci. Vlerësimin mund ta kryejnë edhe vlerësues të autorizuar nga organet e tjera shtetërore, pa kompensim.

4. SHITJA E SENDEVE TË MARRA

Neni 29

Shitja e sendeve të marra, pronës dhe dobisë pasurore në përputhje me këtë Rregullore zbatohet me shitje publike me rrugë elektronike (në tekstin e mëposhtëm shitje publike).

Neni 30

Vendimin për shitjen e sendeve të marra e sjell Bordi Drejtues i Agjencisë.

Shitjen publike të sendeve të marra e zbaton Komisioni i Shitjes i caktuar nga ana e Drejtorit. Komisioni për shitje me anë të shitjes publike ka kryetarin dhe dy anëtarë nga radhët e punonjësve në Agjenci.

Neni 31

Shitja publike shpallet me shpallje të paktën shtatë ditë para mbajtjes së shitjes publike të publikuar të paktën në dy gazeta ditore, nga të cilat njëra që botohet në gjuhën që e flasin të paktën 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, si dhe në faqen e internetit të Agjencisë ku do të prezantohet edhe lista me përshkrim të detajuar të sendeve që shiten. Në shpalljen për shitje publike duhet të jenë të theksuara kushtet e shitjes publike, të dhënat për llojin, sasinë dhe gjendjen e mallit, çmimi fillestar, dita dhe koha e shitjes publike, shuma dhe mënyra e pagesës së garancisë për pjesëmarrje në shitjen publike si dhe dita, koha dhe vendi kur dhe ku do të mundësohet këqyrja dhe shqyrtimi i sendeve që shiten, si dhe lista e sendeve që do të shiten e publikuar në faqen e internetit të Agjencisë.

Neni 32

Në shitjen publike të sendeve të marra mund të marrin pjesë të gjithë personat fizikë dhe personat juridikë.

Në shitjen publike nuk guxojnë të marrin pjesë: personat e punësuar në AMPK, persona të tjerë që zyrtarisht kanë marrë pjesë në uridicë, personi i dënuar ndaj të cilit është zhvilluar procedura gjyqësore ose kundërvajtëse, bashkëshorti, bashkëjetuesi, i afërmi në vijë të drejtë ose

deri në shkallë të katërt në vijë të tërthortë i punonjësve dhe i personit të dënuar ose personit ndaj të cilit është zhvilluar procedura gjyqësore ose kundërvajtëse, personat juridikë ose personat përgjegjës në personat juridikë ose mbrojtësi ose përfaqësuesi juridik i personit uridic në të cilin personi i dënuar është pronar i të paktën 25% të të gjitha aksioneve ose ndodhet në pozitë udhëheqëse.

Kur sendi është blerë nga personi që nuk ka pasur të drejtë të marrë pjesë në shitjen publike, i njëjti nuk ka veprim uridic dhe në atë rast garancia e paguar e blerësit nuk kthehet dhe shpallet shitje e re publike në afat prej 30 ditësh, por jo më të shkurtër se 15 ditë.

Neni 33

Para fillimit të shitjes publike ofertuesit duhet të paguajnë garanci në llogarinë e Agjencisë ose të paraqesin garanci bankare me të cilën garantohet pagesa e garancisë dhe e cila përbën 10% nga çmimi fillestar i sendit të marrë ose sendeve të marra që planifikojnë t'i blejnë.

Afati përfundimtar, dita, muaji, viti dhe ora për futjen e garancisë shënohet në shpalljen për shitjen publike.

Në shitjen publike merr pjesë vetëm ofertuesi që do të paraqesë provë për garancinë e paguar.

Garancia u kthehet menjëherë pjesëmarrësve në shitjen publike që nuk kanë pasur sukses, më së voni në afat prej pesë ditësh pas përfundimit të shitjes publike.

Për kthimin e garancisë nuk është e nevojshme që pjesëmarrësi të dorëzojë kërkesë për kthimin e garancisë.

Garancia i kthehet pjesëmarrësit i cili është shpallur blerës, pasi të kryejë pagesën e tërë shumës nga shitja e realizuar.

Neni 34

Sendet shiten në gjendjen në të cilën ndodhen në momentin e shitjes, dhe blerësi nuk mund të bëjë prapësim për mangësitë e sendit të blerë.

Sendet e marra jepen në shitje publike me çmim fillestar të vërtetuar në vlerësim.

Shitja publike nuk do të zbatohet nëse është i pranishëm vetëm një ofertues.

Procedura e shitjes publike është e vërtetuar me Udhëzimin për procedurën për zbatimin e shitjes publike për shitjen e sendeve të marra dhe pronës së konfiskuar, të publikuar në ueb faqen e Agjencisë.

Neni 35

Sendet e marra në shitjen publike i shiten blerësit i cili ka ofruar çmimin më të lartë.

Nëse shitja publike nuk ka sukses, caktohet e dyta në afat prej 30 ditësh, por jo më shpejt se 15 ditë. Publikimi i shitjes së dytë publike duhet t'i përmbajë të njëjtat të dhëna si e para, ndërsa në shpallje duhet të theksohet shtesë se bëhet fjalë për shitje të dytë publike.

Çmimi fillestar i sendeve të marra nga shitja e parë publike mund të zvogëlohet më së shumti deri në një të katërtën e shumës së vlerës së vlerësuar.

Neni 36

Shitja publike konsiderohet e dështuar nëse në shitjen publike me rrugë elektronike nuk është paraqitur asnjë ofertues.

Nëse ndodhin rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, respektivisht nëse sendet e marra dhe prona e konfiskuar nuk mund të shiten në shitjen e parë publike, Agjencia do të caktojë shitje të dytë publike me çmim fillestar të pronës së marrë të zvogëluar për një të katërtën e vlerës së vlerësuar.

Nëse sendet e marra dhe prona e konfiskuar nuk mund të shiten edhe në shitjen e dytë publike në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, Agjencia do të caktojë shitje të tretë publike me çmim fillestar të sendeve të marra dhe pronës së konfiskuar të zvogëluar për një të katërtën e vlerës së vlerësuar. Nga shitja e dytë deri tek e treta publike duhet të kalojnë të paktën 15 ditë, por jo më shumë se 30 ditë.

Nëse sendet e marra dhe prona e konfiskuar nuk mund të shiten as në shitjen e tretë publike, procedura për shitje mund të përsëritet pas vendimit të sjellë paraprakisht nga Bordi Drejtues, më së voni në afat prej gjashtë muajsh nga dita e shitjes së tretë publike të dështuar. Procedura e përsëritur zbatohet në përputhje me dispozitat për shitjen e sendeve të marra dhe pronës së konfiskuar nga ky ligj.

Sendet e marra dhe prona e konfiskuar që kanë qenë të dhëna për shitje nga ana e Agjencisë dhe të cilat edhe pas shitjes së tretë kanë mbetur të papashitura, Agjencia mund t'i tjetërsojë, ndërsa pronën e konfiskuar ta japë me qira.

Neni 37

Komisioni përpilon procesverbal për rrjedhën e shitjes publike. Në të shënohen të dhënat për sendet e marra, çmimi fillestar, pjesëmarrësit e shitjes publike, çmimi i arritur i shitjes nga ofertuesi i fundit më i lartë. Procesverbalin për shitjen publike e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e komisioni. Në procesverbal shpallet blerësi respektivisht fituesi i shitjes publike.

Shitja publike mbyllet pas kalimit të tri minutave menjëherë pas shfaqjes së ofertës më të favorshme.

Pas shitjes së mbyllur kryetari i Komisionit konstaton se cili ofertues ka ofruar çmimin më të lartë dhe se atij ofertuesi i shitet sendi i marrë ose prona e konfiskuar.

Nëse nuk ekziston skualifikim i pjesëmarrësit në shitjen publike, në kuptim të nenit 49 të Ligjit për menaxhimin me pronën e konfiskuar, dobinë pasurore dhe sendet e marra në procedurë penale dhe kundërvajtëse (*), ndërsa blerësi në afatin e paraparë në paragrafin 1 nga ky nen nuk e depoziton çmimin. Agjencia me Përfundim për shitje mund të vendosë që sendet e marra dhe pronën e konfiskuar t'ia ndajë ofertuesit të ranguar i dyti sipas çmimit që ai ka ofruar.

Për shitjen Komisioni përgatit procesverbal dhe sjell përfundim për shitje të cilin ua dorëzon të gjithë pjesëmarrësve të shitjes publike.

Pas pagesës së çmimit të sendeve të marra dhe pronës së konfiskuar, Agjencia në afat prej tri ditësh sjell përfundim për shitjen e kryer i cili paraqet bazë juridike për fitimin e të drejtës së pronësisë.

Agjencia do të sjellë përfundim për shitjen e sendeve të marra dhe pronës së konfiskuar, pasi të vërtetojë se janë plotësuar kushtet për vlefshmërinë e shitjes.

Përfundimi për shitjen e sendeve të marra dhe pronës së konfiskuar u dorëzohet të gjithë pjesëmarrësve në shitjen publike në afat prej tetë ditësh nga sjellja.

Pas pagesës së çmimit nga ana e blerësit, në afat prej tetë ditësh, Agjencia sjell përfundim për dorëzimin e pronës së konfiskuar në posedim të blerësit.

Përfundimi u dorëzohet të gjithë personave të cilëve u dorëzohet përfundimi për shitjen e paluajtshmërisë.

Neni 38

Procesverbalin për shitjen publike u dërgohet në e-mail pjesëmarrësve të shitjes publike, si dhe i njëjti shpallet edhe në tabelën e shpalljeve të Agjencisë së menaxhimit me pronën e konfiskuar, në afat prej dy ditësh pas shitjes së përfunduar dhe duhet të mbetet i shpallur tri ditë.

Neni 39

Blerësi është i detyruar që menjëherë pas mbylljes së shitjes publike 7% e çmimit të ofruar ta paguajë në shifër të veçantë të të hyrave në llogarinë e depozitave të Agjencisë së menaxhimit me pronën e konfiskuar, ndërsa pjesën tjetër, respektivisht 93% e çmimit të ofruar në shifër tjetër të veçantë të të hyrave në llogarinë e depozitave të Agjencisë. Nëse blerësi nuk e paguan çmimin në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga mbyllja e shitjes publike konsiderohet se blerësi ka hequr dorë nga sendi i blerë dhe garancia e futur prej tij shërben për mbulimin e shpenzimeve të shkaktuara gjatë zbatimit të tërë procedurës për shitje dhe mjetet transferohen në llogarinë e aktiviteteve vetëfinancuese.

Nëse gjatë shitjes publike ndonjë prej ofertuesve ofron ofertë qartazi disproporcionale më të madhe nga vlera e tregut e sendeve të marra dhe pronës së konfiskuar, ndërsa pas përfundimit të shitjes publike nuk e paguan çmimin e ofruar për sendet e marra dhe pronën e konfiskuar të blera, Agjencia do ta shpallë shitjen si të pavlefshme, ndërsa garancia e depozituar nuk kthehet dhe mjetet transferohen në llogarinë e aktiviteteve vetëfinancuese.

Neni 40

Drejtori i Agjencisë sjell vendim për shitjen e kryer të sendeve të marra, blerësit në afat prej tri ditësh pas pagesës së çmimit në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vendimi për shitjen e kryer të sendit të marrë është edhe dokument për shitje. Vendimi duhet të përmbajë përshkrim të detajuar të sendit, çmimin me të cilin është shitur, shumën e detyrimeve të importit të llogaritura nga Drejtoria e Doganave nëse bëhet fjalë për mall të huaj, tatimin mbi vlerën e shitur për çka blerësi duhet të paraqesë provë se është paguar tatimi.

Neni 41

Pronësia mbi sendet e marra kalon te blerësi nga data e lëshimit të vendimit. Blerësi është i detyruar që menjëherë ta tërheqë sendin.

Shpenzimet që lidhen me transportin e sendeve të blera i ngarkojnë blerësit.

Neni 42

Shpenzimet që lidhen me transportin, magazinimin, shitjen e sendeve të marra, dhe shpenzimet për shërbimet e kryera shlyhen nga çmimi i paguar i blerjes të atij sendi ose sendi tjetër.

5. TJETËRSIMI I SENDEVE TË MARRA

Neni 43

Agjencia i shet sendet e marra dhe pronën e konfiskuar pas plotfuqishmërisë së vendimit.

Agjencia sendet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të vendosë të mos i shesë dhe të njëjtat t'i tjetërsojë me vendim të sjellë nga ana e Bordit Drejtues të Agjencisë, për të cilin pëlqim jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në rastet nga paragrafi 2 i këtij neni, Agjencia drejtohet me kërkesë për pëlqim nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila është e detyruar të japë pëlqim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës. Nëse Qeveria nuk jep pëlqim në afatin e përcaktuar, Agjencia e zbaton procedurën për tjetërsimin e sendeve të marra dhe pronës së konfiskuar, në përputhje me dispozitat ligjore pozitive.

Si përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk zbatohet procedura për shitjen e sendeve të marra dhe pronës së konfiskuar të cilat Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendim ua tjetërson organeve shtetërore pa kompensim për nevojat e sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe organeve të tjera shtetërore, institucioneve publike dhe ndërmarrjeve, të themeluara nga shteti dhe komunat, shoqatave dhe fondacioneve.

1) Tjetërsimi i materialit të mbjelljes dhe farërave të marra, produkteve bujqësore dhe të kopshtarisë së hershme, produkteve për mbrojtjen e bimëve, ushqimit dhe pijet joalkoolike

Neni 44

Sendet e luajtshme të marra si materiali i mbjelljes dhe farërave, produktet bujqësore dhe të kopshtarisë së hershme, produktet për mbrojtjen e bimëve, ushqimi dhe pijet

joalkoolike Agjencia mund t'i tjetërsojë pa kompensim organeve shtetërore, institucioneve publike të themeluara nga shteti, shoqatave dhe fondacioneve, për çka e njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Para tjetërsimit të sendeve të marra nga paragrafi 1 i këtij neni, Agjencia siguron raport nga analizat për përcaktimin e makro dhe mikro elementeve dhe elementeve në gjurmë nga Laboratori Shtetëror Fitosemitar pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave ose nga institucionet e tjera relevante që kryejnë analizë dhe ekzaminim për përdorshmërinë e ushqimit. Pas marrjes së raportit, Agjencia i tjetërson sendet e marra nga paragrafi 1 i këtij neni.

Gjatë dorëzimit të mallit të marrë në Agjenci, institucioni që e ka marrë mallin është i detyruar të dorëzojë dokument me të cilin do të konfirmohet rregullsia shëndetësore dhe higjienike e mallit të marrë (me prejardhje bimore ose shtazore), në të kundërt malli nuk do të pranohet nga ana e Agjencisë.

Bordi Drejtues me akt nënligjor e rregullon mënyrën e tjetërsimit të sendeve të marra organeve shtetërore, institucioneve publike të themeluara nga shteti, shoqatave dhe fondacioneve.

2) Tjetërsimi i sendeve të marra si veshje dhe mbathje

Neni 45

Agjencia do të sjellë vendim që sendet e marra si veshje dhe mbathje t'i tjetërsojë pa kompensim organeve shtetërore, institucioneve publike të themeluara nga organet shtetërore, institucioneve publike dhe ndërmarrjeve, të themeluara nga shteti dhe komunat, shoqatave dhe fondacioneve.

Bordi Drejtues me akt nënligjor e rregullon mënyrën e tjetërsimit të sendeve të marra organeve shtetërore, institucioneve publike dhe ndërmarrjeve, të themeluara nga shteti dhe komunat, shoqatave dhe fondacioneve.

3) Shitja dhe tjetërsimi i sendeve të marra dhe pronës së konfiskuar dhe dhënia me qira e pronës së konfiskuar

Neni 46

Agjencia i shet dhe i tjetërson sendet e marra dhe pronën e konfiskuar me vendim të plotfuqishëm dhe e jep me qira pronën e konfiskuar me vendim të plotfuqishëm, pas plotfuqishmërisë së vendimit.

Agjencia mund të vendosë që sendet e marra dhe pronën e konfiskuar nga paragrafi 1 i këtij neni mos t'i shesë, por t'i tjetërsojë organeve shtetërore, institucioneve publike dhe ndërmarrjeve të themeluara nga shteti dhe komunat, shoqatave dhe fondacioneve, pa marrë parasysh nëse do të jenë lëndë e shitjes, e në bazë të kërkesës së dorëzuar për tjetërsimin e sendeve të marra dhe pronës së konfiskuar dhe pëlqimit të marrë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Organet shtetërore, institucionet publike dhe ndërmarrjet e themeluara nga shteti dhe komunat, shoqatat dhe fondacionet që kanë dorëzuar kërkesë për tjetërsimin e automjeteve motorike të marra ose pronës së konfiskuar, janë të detyruara të kryejnë pagesën e 7% nga vlera e vlerësuar e sendeve të marra – automjeteve motorike ose pronës së konfiskuar në llogari të Agjencisë, në afat prej shtatë ditësh pas pëlqimit të marrë nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi vendimin e sjellë nga Bordi Drejtues.

Neni 47

Nëse silltet vendim i plotfuqishëm për kthimin e pronës ose sendit që është shitur, në përputhje me nenin 45 të kësaj rregulloreje, Agjencia pronarit ia paguan mjetet e marra nga shitja, të cilat janë deponuar dhe ruajtur në shifër të veçantë të të hyrave nga llogaria e depozitave të Agjencisë.

Nëse sillet vendim i plotfuqishëm për kthimin e sendit që është tjetërsuar në përputhje me nenin 45 paragrafi 5 alineja 2 nga ky ligj, organi shtetëror të cilit i është tjetërsuar sendi pronarit ia paguan mjetet në lartësi të vërtetuar me vlerësimin e bërë në përputhje me nenin 45 paragrafi 7 të kësaj rregulloreje, të zvogëluar për 7% nga vlerësimi i bërë i vlerës së sendit, të cilat pronarit ia paguan Agjencia, në përputhje me nenin 65 paragrafi 2 alineja 2 të Ligjit për menaxhimin met pronën e konfiskuar, dobinë pasurore dhe sendet e marra në procedurë penale dhe kundërvajtëse („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ (*)) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 64/24, 37/25, 86/25, 101/25, 135/25 dhe 132/26).

Nëse sillet vendim i plotfuqishëm për kthimin e pronës së tjetërsuar të marrë përkohësisht ose sendeve të marra përkohësisht në përputhje me nenin 45 të kësaj rregulloreje, Agjencia pronarit ia kthen sendet e tjetërsuara ose nëse kjo nuk është e mundur, për shkak të natyrës së pronës së marrë përkohësisht ose sendeve të marra përkohësisht ia paguan mjetet në lartësi të vërtetuar me vlerësimin e bërë në përputhje me nenin 45 paragrafi 7 të kësaj rregulloreje nga Buxheti e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 48

Para shitjes së pronës së konfiskuar, Bordi Drejtues mund të dorëzojë propozim të arsyetuar deri te Qeveria e RMV-së, që në vend se të shitet, prona e konfiskuar t'i tjetërsohet organit shtetëror, institucionit publik ose shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve që kryejnë veprimtari në fushën e mbrojtjes sociale pa ndonjë kompensim, e për realizimin e qëllimeve të ripërdorimit social.

Neni 49

Sendet e marra përkohësisht ose prona e konfiskuar dhe dobia pasurore, me qëllim të mbrojtjes së vlerës së tyre, mund të sigurohen.

Vendimin për sigurimin e pronës së caktuar e sjell Bordi Drejtues, me propozim të Drejtorit të Agjencisë.

Prioritet për sigurim ka prona që është me vlerë më të madhe, si dhe prona që përbëhet nga sende luksoze, si dhe prona e cila për shkak të natyrës së lokacionit (zonë me rrjedha të shtuara të ujit, vende malore dhe bregdetare, shkarkime natyrore, reshje dhe ngjashëm), i nënshtrohet rrezikut më të madh të dëmtimit për shkak të fatkeqësive natyrore.

Drejtori i Agjencisë në nivel vjetor zbaton procedurë për prokurim publik për zgjedhjen e operatorit përkatës ekonomik i cili do të kryejë sigurimin e pronës së konfiskuar, në mënyrë dhe procedurë të rregulluar me Ligjin për Prokurimet Publike.

Mjetet për sigurimin e pronës së marrë dhe të konfiskuar janë të parapara në buxhetin e Agjencisë, e alokohen nga përqindja e fituar nga shitja e pronës nga ana e Agjencisë.

Asgjësimi i pronës së marrë dhe sendeve të marra

Neni 50

Prona tjetër e marrë e cila nuk mund të shitet për shkaqe shëndetësore, veterinarë, fitosanitare ose shkaqe sigurie, asgjësohet nga ana e komisionit të formuar nga ana e Bordit Drejtues të Agjencisë.

Produktet e duhanit, alkoolit dhe produkteve të tjera të marra për të cilat nuk ekziston deklaratë ose nëse janë falsifikate, asgjësohen detyrimisht pa marrë parasysh plotfuqishmërinë e vendimeve, përveç për sendet për të cilat zhvillohen procedura penale, asgjësimi i të cilave bëhet pas marrjes së aktgjykimit të plotfuqishëm.

Kufizimi i konfiskimit të dobisë pasurore të fituar në mënyrë të kundërligjshme

Neni 51

Nëse personi nga i cili është urdhëruar të konfiskohet dobia pasurore e fituar në mënyrë të kundërligjshme, vullnetarisht nuk e ka paguar shumën përkatëse të dobisë pasurore të fituar në mënyrë të kundërligjshme, e i njëjti është i punësuar ose është në pension, ose mbi bazë tjetër ka të hyra monetare të vazhdueshme, ka të drejtë që deri te Agjencia të dorëzojë kërkesë që t'i ndalohet shuma nga paga ose pensioni ose të hyrat monetare të vazhdueshme të fituara mbi bazë tjetër, në lartësi prej 1/3 e të hyrave të përgjithshme, sipas së cilës kërkesë drejtori i Agjencisë është i detyruar të sjellë vendim në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës.

6. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 52

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Pas hyrjes në fuqi kjo rregullore do të publikohet edhe në ueb faqen e Agjencisë.

Neni 53

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për veprim me pronën e konfiskuar Nr. 01-713/1 e datës 7 shkurt 2025, e publikuar në („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 50/25), Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për veprim me pronën e konfiskuar Nr. 01-3009/1 e datës 9 korrik 2025, e publikuar në („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/25) dhe Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për veprim me pronën e konfiskuar Nr. 01-4694/1 e datës 30 tetor 2025, e publikuar në („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 252/25).

Nr. 01-3463/1
16.7.2026
Shkup

Agjencia për menaxhimin
e pronës të konfiskuar,
Kryetar i Bordit Drejtues
Stanko Kitanoski d.v.

ФОНД ЗА ЗДРАВСТВЕНО ОСИГУРУВАЊЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

2752.

Врз основа на член 56 став 1 точка 3 во врска со член 54 став 1 точка 8 на Законот за здравственото осигурување („Службен весник на Република Македонија“ број 25/2000, 34/2000, 96/2000, 50/2001, 11/2002, 31/2003, 84/2005, 37/2006, 18/2007, 36/2007, 82/2008, 98/2008, 6/2009, 67/2009, 50/2010, 156/2010, 53/2011, 26/2012, 16/2013, 91/2013, 187/2013, 43/2014, 44/2014, 97/2014, 112/2014, 113/2014, 188/2014, 20/2015, 61/2015, 98/2015, 129/2015, 150/2015, 154/2015, 192/2015, 217/2015, 27/2016, 37/2016, 120/2016, 142/2016 и 171/2017 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ број 275/2019, 77/2021, 285/2021, 60/2023, 154/2023, 209/2023, 144/2025, 154/2025 и 91/2026), Управниот одбор на Фондот за здравствено осигурување на Република Северна Македонија, на седницата одржана на 10 јули 2026 година, донесе

